



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:163185

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05722820

KE.nr. 585/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit Express Posta L.L.C., me seli në Uglar, Komuna Graçanicë, të cilin e përfaqëson me autorizim Fatos Zeqiri, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës EM Corporation SH.P.K., me seli në Prizren, të cilin e përfaqëson Agim Morina, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 22.05.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia me numër KE.nr. 585/23, e datës 28.07.2023 (2023:163185), e paditësit Express Posta L.L.C., ndaj të paditurit EM Corporation SH.P.K., me objekt kontesti shkelje e markës tregtare.
- II. Shpenzimet e procedurës i bart se cila pale veç e veç.

**A r s y e t i m**

Paditësi Express Posta L.L.C., me datën 28.07.2023, pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, ka paraqitur padi për shkelje të markës tregtare ndaj të paditurës EM Corporation SH.P.K.

Gjykata Komerciale ka caktuar seancën për shqyrtimin kryesor për datën 22.05.2024, në të cilën seancë, nuk ka marr pjesë përfaqësuesi me autorizim i palës paditëse avokati Fatos Zeqiri.

Nga shkresat e lëndës, respektivisht nga fletë kthesa e postës, rezulton se i autorizuari i palës paditëse, thirrjen për këtë seancë e ka pranuar në mënyrë të rregullt me datën 11.04.2024, ndërsa i njëjti nuk ka prezantuar në seancën për shqyrtimin kryesor të datës 22.05.2024 dhe mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë formë.

Përfaqësuesi i palës së paditur, Agim Morina në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 22.05.2024, i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr.

Andaj nisur nga fakti se paditësi ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për këtë seancë dhe se i njëjti nuk ka marr pjesë në seancë, si dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, gjykata duke u bazuar në nenin 423 paragrafin 3 të LPK-së, më të cilin përcaktohet se: *“Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit.”*, ka marr aktvendim me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 423 par.3 dhe nenin 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.585/23, datë 22.05.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.